

UDHËZIMET PËR PLANIFIKIMIN, ORGANIZIMIN DHE ZBATIMIN E
MËSIMDHËNIES PLOTËSUERE DHE SHTUESE
NGA KLASA E I - VI NË ARSIMIN FILLOR NË VITIN SHKOLLOR 2023/24

MËSIMI PLOTËSUES

Planifikohet dhe zbatohet në baza javore sipas nevojave të nxënësve (të cilët nuk arrijnë standardet e vlerësimit të planifikuara për atë javë) në kuadër të qëndrimit të detyrueshëm të nxënësve, përkatësisht mësimdhënësve.

Planifikimi i mësimi plotësues në arsimin fillor është pjesë përbërëse e planifikimit javor (sipas vëzhgimeve të mësimdhënësit nga përmbajtjet e realizuara dhe arritjet e nxënësve) për të cilën nxënësit informohen. Realizimi evidentohet në ditarin elektronik në kolonën për mësim plotësues.

Në mësimin lëndor, planifikimi reduktohet vetëm në përcaktimin e kohës së zbatimit gjatë javës vijuese (sipas vëzhgimeve të mësimdhënësit për përmbajtjet e realizuara dhe arritjet e nxënësve) në nivel paralele/klase, për të cilën nxënësit informohen. Realizimi evidentohet në ditarin elektronik në pjesën për mësim plotësues.

MËSIMI SHTUES

Lëndët e lira zgjedhore mundësojnë zgjerimin dhe thellimin e njohurive të nxënësve për një lëndë/fushë të caktuar, duke prezantuar kështu një nga format e mësimdhënies plotësuese. Nëse nxënësit shfaqin interes për të përmirësuar njohuritë dhe aftësitë e tyre dhe nuk përfshihen në një lëndë zgjedhore e lirë, organizohet një formë tjetër e mësimdhënies shtuese. Gjithashtu, përgatitja e nxënësve për gara është një nga format e mësimdhënies shtuese.

Nëse mësimi shtues është lëndë zgjedhore e lirë, lënda planifikohet si çdo lëndë tjetër mësimore, hyn në orarin e rregullt të nxënësve dhe evidentohet në pjesën e evidentimit të orëve në ditarin elektronik.

Format e tjera të mësimdhënies plotësuese në shkollën fillore janë pjesë përbërëse e planifikimit javor për të cilin nxënësit informohen. Realizimi evidentohet në ditarin elektronik në pjesën për mësimin shtues.

Në mësimin lëndor planifikimi reduktohet vetëm në përcaktimin e kohës së realizimit gjatë javës në nivel paralele/klase, për të cilën informohen nxënësit. Realizimi evidentohet në ditarin elektronik në pjesën për mësimin shtues.